



Znj. Edlira Cimbi ka lindur në Tiranë më 21.02.1974, është e martuar dhe nënë e dy fëmijëve. Në prill 2020 është emëruar Drejtoreshë e Departamentit të Shërbimeve Ligjore në Këshillin e Lartë të Prokurorisë (KLP), detyrë që e ushtron edhe aktualisht.

Ka kryer studimet në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, në vitet 1992- 1996 ku është diplomuar në vitin 1996, si dhe ka kryer studimet pasuniversitare në drejtimin Administrim Biznes në Tiranë. Znj. Cimbi mbanë titullin “Master shkencor” në këtë degë, si dhe titullin “ Avokatit” që prej vitit 2006.

Prej 25 vitesh ushtron profesionin e juristes, kryesisht në sektorin publik, por gjatë rrugëtimit profesional ka mbuluar dhe sfera të së drejtës tregtare dhe kontraktuale për kompani tregtare strategjike.

Ka nisur karrierën profesionale si juriste në vitin 1997, fillimisht në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Muzeu Historik Kombëtar, e më pas ka punuar në departamentet ligjore të kompanive strategjike, në tregun e telekomunikacionit siç ishte Albtelecom sh.a, në periudhën 1998-2009 dhe më pas në kompaninë ARMO sh.a, në tregun e hidrokarbureve, në vitet 2009-2013 ku ka pasur rol drejtues.

Në vitet 2010- 2015 ka ushtruar profesionin e avokatit dhe në vitet 2015-2019 ka ushtruar detyrën si Drejtore e Administrimit të Brendshëm në Agjencinë e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara, (ADISA) Sektori Publik. Kjo drejtori mbulonte katër sektor, konkretisht Sektorin Juridik, Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Protokollit, Sektorin e Trajnimeve dhe Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse.

Gjatë ushtrimit të kësaj detyre ka kontribuar për implementimin e reformës së administratës publike dhe konkretisht në shërbimet publike ndaj qytetarit, në hartimin e strategjive të zhvillimit të reformës, të metodologjive të cilat çojnë në përmirësimin e cilësisë, standartizimit të shërbimeve publike, dixhitalizimit të proceseve si një armë e fortë kundër korrupsionit në administratën publike.

Gjatë viteve të punës ka kryer një sërë trajnimesh profesionale brenda dhe jashtë shtetit duke mundësuar rritjen e kapaciteteve të saj profesionale.